

VENDIM QARKULLUES

Nr. 25, datë 5.8.2021

PËR ANËTARËSIMIN E SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “RRUSHKULL ONE” NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 22, pika 5 dhe pika 6, të nenit 23 dhe nenit 52, pika 1, shkronja “p”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 69, pika 2, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, të nenit 7, pika 2 dhe pika 3, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18, pika 2, të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe të njoftimit të Bankës së Shqipërisë mbi dhënien e licencës shoqërisë së kursim-kreditit “Rrushkull One”, me anë të shkresës nr. 3541/1 prot., datë 30.7.2021 (ardhur në Agjenci më datë 4.8.2021), me propozim të drejtorit të përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Anëtarësimin e shoqërisë së kursim-kreditit “Rrushkull One”, në skemën e sigurimit të depozitave, si dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autorizohet drejtori i përgjithshëm për njoftimin e shoqërisë së kursim-kreditit “Rrushkull One” për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe për dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave, si dhe të informojë Autoritetin Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

4. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Martin Blushi

KRYETAR
Donald Duraj